

SPECIFIKIME TEKNIKE

PER PROJEKTIN: RIKONSTRUKSION RRUGA "BREGU I HAZËS", NJ/A QUKËS, BASHKIA PRRENJAS

Projekti është hartuar në baze të matjeve direkt në terren dhe ka për qëllim detajimin e hollësisht të objektit, e cila konsiston në këto procese pune :

1. Skarifikimin e rrugës.
2. Zgjerimin e rrugës në permatat që kerkohen sipas projektit.
3. Shtrimi i rrugës me zhavor granit në të gjithë gjatësinë e saj dhe ngjeshja me makineri.
4. Ndertimi i kanalit anësor në permata 0.25x 0.25 cm në anë të djathtë të rrugës ose nga ana lindore e pozicionit të rrugës dhe betonimi i tij.
5. Vendosja e hekurit në bazamentin e rrugës në të gjithë gjatësinë e tij.
6. Betonimi i rrugës me beton M-300 në të gjithë gjatësinë e tij.

Preventivi për të gjitha zërat është hartuar sipas manualit të çmimeve me Vendimin nr. 216, datë 13.4.2023, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

3.89/b: Germim dheu me eskavator me goma 0.25 m³ në kanale me gjatësi b > 2 m të zakonshme të kategorisë së tretë me eskavator me shkarkim në auto (skarifikim rrugë).

Ky çmim ka të bëjë me teresin e punimeve që lidhen me germimin skarifikimin e trupit të rrugës, germimin e dhe hapjen e trasës me seksion sipas profileve tërthore të trupit të rrugës me eskavator me goma .

Në germim duhet respektuar profilet sipas gjatësisë dhe pjerresisë .

Materiali i germuar duhet të transportohet me kamion në një vend të caktuar nga Bashkia Prrenjas.

Analiza 3.207/1.

Shtrese çakelli tr -15 cm, perhapur e ngjeshur me makineri.

Ky cmim perfshin teresine e punimeve qe lidhen me ndertimin e shtreses me cakull, me tr-10 cm si shtrese e pare baze e trupit te rruges me granulometri 5-35 mm, me permbajtje te materialit te imet (permiresimi < 10 mm), jo me shume se 15 % te materialit te imet dhe te shtreses .

Ketu perfshihen blerja e çakellit me granulometri 5-35 mm, me permbajtje te materialit te imet, ngarkim trasporti deri ne objekt, shkarkimi, shtrimi dhe rrafshimi i shtreses, e cila pasi te ngjeshet me rul me P-12 Ton te realizoje me kompaktesine > 90% dhe trashesine 10 cm .

Kjo ka te beje me realizimin e nje m² shtrese me tr-10 cm te realizuar ne objekt.

2.52/2: Mur guri themel e xogel me llac m-250 .

Ky cmim perfshin teresine punimeve qe kane te bejne me nje sere procesesh punimesh per ndertimin e murit mbajtes.

Ketu perfshihet blerja e materialeve si rere, granil cimento dhe gure , trasporti i materialeve , vendosja e çimentos ne nje vend te thate pa lageshti .

Llaci qe do te behet duhet te jete M-250.

Çimentua qe vjen ne vendin e punes duhet te jete e paisur me flete garancie me dt. skadence per tu siguruar qe te perdoret per beton .

Kur vjen beton i perzier me betoniere duhet te merren kampione betoni ne kallepe 15x 15 cm per t'iu nenshtruar analizave ne labororet fizike te akredituara nga shteti te licencuara te cilat provohen ne qendueshmeri ne shtytje dhe shtypje, te shoqeruara me çertifikate perkatese.

Ndertimi i ketij muri sherben per te sistemuar nje gjatesi 20.0 ml vend qe eshte pa mbeshtetje nga ana lindore e pozicionit te rruges.

Rera duhet te jete e paster e lare pa perzierje te lendeve ose materialeve te panevojshme

Kjo ka te beje me 1m³ mur guri te ndertuar dhe te perfunduar.

An 1.31/1 .Shtrese betoni C-25/ 30 (betonim i rruges dhe i kanalit anesor)

Qellimi i punes qe perfshin kjo analize eshte zbatimi i procesit te betonimit konform standarteve , kushteve teknike dhe kerkesave te projektit gjate ndertimit ese realibitimit te rrugeve .

Kryerja e ketij procesi duhet te behet me makineri perkatese perzieres betoni trasportues betoni vibrator mekanik , veglat epunes , materiale dhe paisje te tjera si pompa paisje topografike qe jane te domosdoshme per perfundimin dhe ne sasine dhe cilesine e duhur te ketij procesi.

Çimentoja qe vjen ne vendin e punes duhet te jete e pajisur me flete garancie me dt. skadence per tu siguruar qe te perdoret per beton.



FOTO MODEL E BETONIT PAS HEDHJES DHE SISTEMIMIT.

Kur vjen beton i perzier me betoniere duhet te merren kampione betoni ne kallepe 15x 15 cm per t'iu nenshtuar analizave ne laboratoeret fizike te akredituara nga shteti te licencuara te cilat provohen ne qenduesmeri ne shtytje dhe shtypje, te shoqeruara me çertifikate perkatese.

Kur çimento vjen i paketuar me thase vendoset ne vendin e punes 15 cm mbi nivelin e tokes per tu mbrojtur nga lageshtia.

Çimento nuk duhet te qendroje me shume se tre muaj ne vendin ne kantier pa lejen e supervizorit.

Ne fillim te Kontrates ,Kontraktori duhet te paraqese tek supervizori propozimin e tij per organizimin e aktiviteteve te betonimit ne shesh icili duhet te permbaje :

- Vendosjen dhe shtrirjen e paisjeve te prodhimit te betonit
- Metodatat epropozuara per organizimin e paisjeve te prodhimit te betonit.
- Procedurate kontrollit te cilesise se betonit dhe materialeve te betonit.
- Trasporti dhe hedhja e betonit.
- Detaje te punes se blerjes te kallepeve duke perfshire kohen e heqjes te se kallepeve dhe procedurate tjera .

KONTROLLI I CILESISE

Kontraktori duhet te kete ne stafin e tij nje inxhinier ndertimi te kualifikuar , te specializuar me licence perkatese dhe me eksperience , i cili do te jete pergjegjes per kontrollin e cilesise se te gjithe betoneve

Materialet dhe mjeshteria e ne punimete e betonit duhet te jete e nje cilesie shume te larte qe te jete mundur .

Kontrolli i cilesise do te behet konform kushteve teknike dhe standarteve perkatese ne prezence te ing te ndertimit dhe Supervizorit te punimeve te cilet do te jene pergjegjes per cilesine ebetoneve te hedhura ne veper .

PUNA PREGATITORE DHE INSPIKTIMI

Perpara se te kryhet procesi i betonimit armaturat duhet te pastrohen nga pluhurat dhe te sperkaten me uje .

Asnje proces betonimi nuk duhet te kryet pa inspektuar supervizori te gjithë procesin e pregatitjes dhe hedhjes se betonit.

Supervizori mban pergjegjesi per germimin per mbrojtjen nga kushtet atmosferike, fiksimin armimin fugaturat si dhe te gjitha materialet etjera perbetonim.

MATERIALET PER BETONIM

Nje nder materialet me te rendesishme qe perdoret per betonet dhe qe duhet ti enshtohet kontrollit teknik eshte çimento.

Gjate betonimit mund te perdoren dy lloje cimento si me poshte :

- Çimento Portland e zakonshme do te perdoret sipas standarteve ISO ose ASTM C--150 tipi II ose Tipi V.
- Kjo lloj cimento do te perdoret per betonet qe nuk jane ne prezence te ujrave te zeza tubove te gazit apo ujrat nentokesore.

Çdo lloj cemento e ngurtesuar apo e demtuar nuk duhet te perdoret.

Çdo ngarkese apo dergese cemento duhet te jete e shoqeruar me flete shoqerimi dhe flete analiza perkatese te fabrikes prodhuese.

Çimento e perfitur nga pastrimi i thaseve apo dhe pastrimi i dyshemese nuk do te perdoret.

Supervizori ka te drejte te kerkoje rietikimin e cimentos kur ka dyshime per mbi cilesine e saj apo gjendjen aktuale .

INERTET

Inertet per te gjitha tipet e betoneve duhet te perdoren duke respektuar STASH --512--78ose ne perputhje me ASTM C-33

Ato duhet te jene te forta te paster pa lende organike te qendrueshme ose masa te tjera te demshme .

Inertet duhet te sigurohen nga burime te njohura te licencuara qe sigurojne rezultate te kenaqshme . per te gjitha llpjet ebetoneve .

INERTET E IMTA

Inertet e imta per te gjitha llojet e betoneve te M-100 , 200 ,

300 duhet te jene konform STASH 512-78 DO TE JENE

PREJ RERE NATYRALE TE LARE apo inerte te tjera te njohura me karakteristika te njejta .

Permajtje te tjera te llumit apo dhe substanca te tjera eshte 5%.

Raporti me i pershtatshem i volumit te duhet te vendoset nga prova e ngjeshjes se inerteve te imta dhe te trasha te kubikeve te betonit.

Keta kubike duhet te testohen ne laboratore ne kushte te njejta. Keta kubike duhet te testohen nga 7, 14 ose 28 dite.

Gjate betonimit duhet te perdoret vibrator per te vibruar betonin i cili siguron nje shperndarje te rregullt dhe mbush boshlleqet qe krijohen.

Rruges me beton gjate shtrimit duhet ti jepet nje sip e ashper me kanale 2x2 cm dhe te jene kanalet ne drejtim te kanalit per kullimin e ujrave.

Per raportet e ndryshimeve te inerteve vendos supervizori i punimeve

PROVAT E FORTESISE SE BETONEVE .

Kontraktori duhet te siguroje per qellimet e provave nje set kubiksh per çdo strukture betoni perfshire derdhje betoni nga 1-15 m³.

Per hedhje betoni me shume se tre m³ duhet te merren nje set kubikesh shtese.

An 2.166 F V Hekur beton periodik Ø 6-10 mm Punime hekuri (ne kete rast Ø 8 dhe 10 mm)

Ne kete analize perfshihen blerja, trasporti i hekurit qe duhet te behet dhe transportohet me kamion ne vendin e punes shoqeruar me flete garancie per qendueshmerine ne perkulje dhe terheqje .

Hekuri nuk duhet te jete me ndryshk apo me elemente te tjere, te jete i drejte dhe jo me deformime .

Pasi te jete siguruar mire shtrsea e granilit apo zhavorit qe nga perhapja, ngjeshja ne menyre te njetrajtshme behet vendosja e hekurit Ø--10 ne drejtimin gjatesor dhe hekurit Ø -8 mm ne drejtim terthor te rruges.

Behet lidhja e hekurit Ø 8 dhe 10 me tel bari dhe fiksuar ne toke me kunja hekuri ne forme u -je te bera vete .

Pasi te jete vendosur mire hekuri dhe te jemi te sigurte qe eshte gati per beton behet hedhja e betonit me Tr--15 cm te betonit ku do te merren kampione betoni 15x 15 cm per t'iu nenshtruar analizave per te provuar fortesine si kemi theksuar me lart. Pepara se te hidhet betoni behet larja me uje e kallepeve te vendosura dhe e shtreses te granilit per te bere te mundur qe betoni te behet nje trup i vetem me shtresen .

Gjate hedhje te betonit te perdoret vibratori per te mundesuar perhapjen dhe mbushjen e boshlleqeve qe krijohen gjate betonimit..

Pasi te perfundoje betonimi e cila sip te jet me kanale te vogla 2 cm ne drejtim te kanalit per te mundesuar rrjedhjen e ujrave te shiut ne kanal mbas 3 ore ne varesi te kohes e temperaturave behet sperkatja me uje disa here ne dite 4-5 here dhe disa ditë derisa betoni te fitoje fortesine qe duhet sic theksuam me lart 7.14 ose 22 ditë. Dhe pas 22 ditesh te behet e mundur kalimi i mjeteve.

3.408 F V Tuba metalik D-219 mm

Tubat metalike do te vendosen ne kalimet e dyta per ne lagje apo hyrjet e familjeve per ne banese.

Tubat do te vendosen ne kanalin anesor te betonit dhe do te mbulohet me beton .

Trashesia e betonit ne rruge dhe kanalit te jet ne nje nivel, per te mos krijuar pengesa ne hyrjen e banesave.

FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE







Pergatiti: Ing. Kastriot Begaj